



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 229, datë 13.4.2022

P Ë R

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.61, DATË 3.2.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PAKETAVE TË PAJISJEVE
MJEKËSORE TE RIMBURSUESHME", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika 9/1, e vendimit nr.61, datë 3.2.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9/1. Lista e pajisjeve mjekësore (fisha diabeti) që do të rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për vitin 2022, për pacientët e grupmoshës 0-25 vjeç, është sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi."

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Ngarkohet Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**MINISTRIT SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

OGERTA MANASTIRLIU

Shtojca Nr. 1

Lista e pajisjeve mjekësore (fisha diabeti) të rimbursueshme, që tregtohen në farmacitë e spitaleve.

Nr.	Emri i pajisjes	Emertimi i pajisjes sipas Rregjistrit të AKBPM	Njesia	Prodhuesi	Çmimi i tregtimt me shumicë/njësi, në lekë, me TVSH	Çmimi i Pacientit	Rimbursimi
1	Fishë Diabeti	On Call plus Blood Glucose Monitoring system, glucose strip	Fishë	ACON Laboratories, Inc. 5850 Oberlin Drive, #340 San Diego, CA 92121 USA	14	0	14
2	Fishë Diabeti	Smart Check II set	Fishë	Major Biosystem Corp. 7F.,No.186, Jian-Yi RD., Jung-He District 285 New Taipei City Taiwan	17	3	14
3	Fishë Diabeti	Mates/Meter per glukozen ne gjak, Stripa testues per glukozen ne gjak, Kontroll testet per glukozen ne gjak	Fishë	Hangzhou Sejoy Electronics & Instruments Co., Ltd. Building 2, No. 202, Zhenzhong Road West Lake Economy & Technology Zone 310030 Hangzhou China	19	5	14
4	Fishë Diabeti	Viva check Ino boold glucose system	Fishë	VivaChek Laboratories, Inc. 913 N Market Strët, Suite 200 Wilmington, DE 19081 USA	22	8	14
5	Fishë Diabeti	Aparate B-Sensor dhe fisha per matjen e glicemise.	Fishë	Visgenër Inc. No.335, Sec.6, Zhonghua Rd. 30094 Hsinchu City Taiwan	24	10	14
6	Fishë Diabeti	Acu-Check Active Kit qe permban aparat, fisha dhe lanceta per matjen e glicemise	Fishë	Roche Diabetes Care GmbH, Sandhofer Strasse 116, 68305 Mannheim, Germany	38	24	14
7	Fishë Diabeti	Fije per aparat Gluco + per matjen e nivelit te sheqerit ne gjak	Fishë	Andon Health CO., Ltd. No. 3Jinping Strët, YaAn Road, Nankai District Tiannjin, 300190 China	38	24	14
8	Fishë Diabeti	Accu Check Instant Kit qe permban aparat, fisha dhe lanceta per matjen e glicemise	Fishë	Roche Diabetes Care GmbH Sandhofer Strasse 116 68305 Mannheim GERMANY	40	26	14
9	Fishë Diabeti	One Touch Delica	Fishë	Lifescan Europe, A Div. of Cilag GmbH International Gubelstrasse 34 6300 Zug Switzerland	40	26	14

10	Fishë Diabeti	Aparat Contour Plus per matjen e nivelit te glukozes ne gjak.	Fishë	Ascensia Diabetes Care Holdings AG Peter Merian-Strasse 90, 4052 Basel Switzerland	40	26	14
11	Fishë Diabeti	Fije per aparat Gluco + per matjen e nivelit te sheqerit ne gjak	Fishë	Roche Diabetes Care GmbH, Sandhofer Strasse 116, 68305 Mannheim, Germany	41	27	14

* Kompanitë Importuese kanë deklaruar dhënien falas të aparateve për matjen e glicemisë si edhe gjilpërave shpuese (1 në ditë).

NR.PROT. 2118/1
DATË 16.6. 2022

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

